



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1764/14 Prot.

Tiranë, më 02.12.2020

V E N D I M

Nr. 52 datë 02.12 2020

PËR

MIRATIMIN E PAGESËS SË KOMISIONEVE ZGJEDHORE,
PËR ZGJEDHJET E ZHVILLUARA
NË MUAJIN KORRIK 2020,
NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS

Në mbështetje të pikave 3 dhe 4 të nenit 3, nenit 49, të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në RSH “, Rregullores financiare dhe të shpërndarjes së të ardhurave”, miratuar me Vendim BA nr. 35 datë 21.10.2019, në pikën 12, të nenit 7 të Rregullores e zgjedhjeve nr. 213/4 datë 10.02.2020 “Për organizimin e zgjedhjeve të para për autoritet dhe autoritet drejtuese në UST”, VKM nr. 329 datë 12.04.2017 “Për statutin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik”, Relacionin përkatës, Vendimin e Senatit nr. 48 datë 27.11.2020”Për miratimin e propozimit për pagesën e komisioneve zgjedhore ..”, Bordi i Administrimit

V E N D O S I:

1. Të miratojë pagesën për pjesmarrje në komisione zgjedhore për zgjedhjet të zhvilluara në muajin korrik 2020, në Universitetin e Sporteve të Tiranës, sipas tabelës bashkëngjitur:
2. Shpenzimet për pagesën e komisioneve mbulohen nga të ardhurat e Universitetit të Sporteve të Tiranës.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori , Drejtorja e Financës dhe Buxhetit në Universitetin e Sporteve të Tiranës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në www.ust.edu.al dhe tek portali i transparencës universitare

KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Hysen Domi

